ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA RAHOVEC**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **623-25-1580-5-1-1 dhe nr. I brendshëm: 623-25-026-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Asfaltimi i rrugës Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastasel – Polluzhë**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"JOOS&KRASNIQI-BAZË" SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Junik
(Adresa)
Komuna e Gjakovës
(Vendi)
+383 49 766 804
(Numri Telefonit)

51050
(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)

Agron Krasniqi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@jooskrasniqi.com
(Adresa elektronike)

20.05.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

SH.P.K JOOS KRASNIQI-BAZE 810962309 JUNIK

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1. Data e njoftimit për kontratë - 28.04.2025
2. Data e planifikimit te hapjes se ofertave - 23.05.2025
3. Kërkesa për Rishqyrtim – 08.05.2025
4. Vendimi i Autoritetit Kontraktues – 12.05.2025
5. Ankesa e parashtruar ne OSHP – 20.05.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Ende nuk ka proces te hapjes, ankesa drejtohet ndaj kërkesave dhe specifikacionit teknik te dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** ☐

Te bashkangjitur ne kete ankesë gjeni edhe kërkesën per Rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- **Neni 1 - LPP – Qëllimi**
- **Neni 6 - Ekonimiciteti dhe efikasiteti**
- **Neni 7 - LPP - Barazia ne Trajtim/ Jo- Diskriminimi.**
- **Neni 28 - LPP - Specifikimet teknike**
- **Neni 69 - LPP - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale**
- **Neni 71 – LPP- Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në datën 08.05.2025, kemi paraqitur një kërkesë për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues, duke paraqitur faktet dhe dëshmitë që tregojnë se është bërë shkelje e ligjit të prokurimit publik dhe akteve nënligjore, me kritere të përcaktuara në dosjen e tenderit, në njoftimin për kontratë, si dhe në specifikimet teknike nga ana e Autoritetit Kontraktues.

Në datën 12.05.2025, kemi pranuar vendimin nga ana e autoritetit kontraktues, me të cilin eshte refuzuar kërkesa për rishqyrtim nga ana e AK.

Te pakënaqur me vendimin e autoritetit kontraktues konform te drejtës qe na e ljojn ligji dhe afateve te parapara ligjore parashtrojm ankesë pran OSHP-së me deklaratën dhe faktet si me poshtë ne kete ankesë:

Kronologjia e fakteve dhe Analiza e Ankesës

Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), parashtrojmë Ankesë ndaj vendimit të autoritetit kontraktues, Komuna Gjakovë të datës 12.05.2025 konkretisht ndaj kërkesave dhe specifikave te tenderit dhe kritereve te vlerësimit ne tenderin e shpallur me emër: **Asfaltimi i rrugës Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastasel – Polluzhë**

Ankesa do te fokusohet ne kriteret e atakuara nga ana e jonë si me poshtë:

Pika 1: **Kerkesa për dron** – Kërkesë e pajustifikuar dhe diskriminuese (Shkelje e neneve 6, 7, 28 të LPP)
Autoriteti Kontraktues ka kërkuar ne Aneksin 9. PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM pika 44, që OE të paraqesë dron profesional për inspektim, monitorim apo rilevim gjeodezik, me kamerë jo më pak se 60MP, sistem PPK, aprovim nga AAC dhe trajnim nga prodhuesi.
Kjo kërkesë është:

- E pajustifikuar teknikisht, pasi në realizimin e punimeve të asfaltimit nuk ka asnjë nevojë funksionale për përdorim të dronit.
- Në paramasën e punimeve të bashkangjitur me dosjen e tenderit nuk është specifikuar asnjë punë që kërkon përdorimin e dronit, qoftë për matje, skanime ajrore, ortofoto apo ndonjë proces tjetër. Kjo vërteton se kërkesa për dron në dokumentet e tenderit nuk është në funksion të objektit të kontratës, dhe për rrjedhojë përbën kërkesë të panevojshme, të pajustifikuar dhe diskriminuese, në kundërshtim me nenin 28.2 të LPP.
- Kërkesat për rezolucion 60MP, sistem PPK, trajnim nga prodhuesi, leje në emër të inxhinierit dhe kopje të noterizuar janë tejet kufizuese dhe favorizojnë një numër shumë të vogël operatorësh dhe duke krijuar barriera të pajustifikuara për pjesëmarrje të barabartë.

Si OE kërkojmë:

- Të hiqet tërësisht kërkesa për dron nga dokumentacioni i tenderit, si kërkesë që nuk lidhet me objektin e kontratës, nuk është e justifikuar teknikisht dhe cenon konkurrencën e drejtë.
- Punimet gjeodezike dhe topografike të nevojshme për këtë projekt rrugor mund të kryhen me saktësi të lartë përmes pajisjeve standarde dhe të përdorura gjerësisht në inxhinieri, si:

- Total station (stacion total) për piketim preciz të trasesë dhe elementeve të projektit;
- GNSS (GPS profesional) për pozicionim gjeodetik dhe orientim të terrenit.

Këto pajisje janë efektive, të standardizuara dhe të certifikuara për projektet e natyrës së tillë, dhe janë përdorur në mënyrë të suksesshme në projekte rrugore të ngjashme brenda dhe jashtë vendit.

- Në rast se OSHP e vlerëson përdorimin e dronit si të domosdoshëm, kërkojmë që specifikimet të ndryshohen, duke:
  - Lejuar përdorimin e pajisjeve alternative gjeodezike të barasvlefshme;
  - Hequr kufizimet në rezolucion, trajnim dhe pronësi të lejes së AAC;
  - Të lejohet përdorimi i dronëve të licencuar nga bashkëpunëtorë të jashtëm.

Pika 2: Kërkesa për noterizim të dokumenteve – Shkelje e nenit 26.16 të Rregullores 001/2022 dhe nenit 7 të LPP
Kërkesa që marrëveshjet për qira të pajisjeve të jenë të noterizuara bie ndesh me nenin 26.16 të Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022, i cili e bën të qartë se në rast të dyshimit, verifikimi mund të bëhet nga vetë autoriteti, pa kërkuar noterizim. Kjo krijon barrë të panevojshme administrative dhe është diskriminuese ndaj operatorëve që përdorin pajisje me qira. Kjo eshte pasqyruar se fundmi edhe ne nje prej vendimeve te OSHP-së konkretisht ne vendimin me numër me numër 2025/0197, të datës 07.05.2025, ku specifikisht eshte vlerësuar se duhet te largohet si kerkesë nga dosja e tenderit.

Pika 3: Specifikimi i grejderit 19–20 ton – Shkelje e neneve 28 dhe 7 të LPP
Autoriteti Kontraktues ne Aneksin 9. PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM pika18, ka përcaktuar që grejderi i kërkuar duhet të ketë peshë specifike 19–20 ton, duke përjashtuar automatikisht të gjitha pajisjet jashtë këtij intervali, pavarësisht performancës së tyre teknike.
Kjo kërkesë është:

- Teknikisht e pajustifikuar, pasi në praktikën e ndërtimit të rrugëve përdoren gjerësisht grejderë me peshë që varion nga 14 deri në 18 ton, të cilët kanë kapacitete të plota për të përmbushur kërkesat për nivelim, profilizim dhe formësim të trasesë.
- Pesha nuk është tregues absolut i performancës funksionale – elementë si fuqia motorike, gjerësia dhe rregullimi i tehut, sistemet e kontrollit dhe manovrueshmëria janë faktorë shumë më të rëndësishëm për efikasitetin e punimeve.
- Nuk ka asnjë dokument teknik ose arsyetim projektues nga autoriteti kontraktues që justifikon këtë kufizim të ngushtë të peshës.

Si rrjedhojë, kjo kërkesë për grejder me peshë të detyrueshme prej 19–20 ton përbën kufizim të pajustifikuar të konkurrencës dhe shkel dispozitat e nenit 28.2 të LPP, i cili ndalon specifikimet teknike që përjashtojnë operatorë të tjerë që ofrojnë zgjidhje funksionale të barasvlershme. Po ashtu, shkel nenin 7 të LPP, që garanton trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues për të gjithë pjesëmarrësit.

Pika 4: Formulimi "sa më i detajuar" në kërkesat teknike – Shkelje e nenit 52.3 dhe 7 të LPP

Në Fletën e të Dhënave të Tenderit (FTD), Seksioni II, pika 9.1 dhe 9.2, Autoriteti Kontraktues ka vendosur këto kërkesa:

- Kërkesa 7: "Operatori Ekonomik duhet të ofrojë së bashku me ofertë planin për menaxhimin e trafikut sa më të detajuar, duke përfshirë përshkrimin dhe skicat e rrugës që do të realizohet."

- Dëshmia 8: "Plani dinamik sa më i detajuar – Gantogrami, i punuar nga Menaxheri i Projektit dhe Udhëheqësi i Punishtes, dhe duhet të jetë i nënshkruar dhe vulosur nga kompania."

Këto kërkesa janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 52.3 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili përcakton se:

"Kriteret e vlerësimit duhet të jenë objektive, të matshme dhe të lidhura me objektin e kontratës."

- Termi "sa më i detajuar" është i paqartë dhe jo i matshëm – nuk specifikon përmbajtje minimale, as ndonjë standard teknik që duhet ndjekur, dhe nuk ka kritere vlerësimi të përshkruara për të krahasuar apo gjykuar dokumentet ndërmjet ofertuesve.
- Në këtë formë, autoriteti kontraktues mban një diskrecion të pakufizuar për të refuzuar një plan teknik për arsye të pamatshme ose subjektive, duke rrezikuar barazinë në trajtim.
- Kjo bie ndesh gjithashtu me nenin 7 të LPP, i cili garanton trajtim të barabartë, transparencë dhe jo-diskriminim për të gjithë operatorët ekonomikë.

- Kriteret e paqarta dhe subjektive jo vetëm që rrezikojnë integritetin e procesit të prokurimit, por cenojnë edhe sigurinë ligjore të operatorëve, të cilët nuk e dinë me saktësi se çfarë përmbajtje është e pranueshme dhe si do të vlerësohen dokumentet e tyre. Si përfundim te kësaj pike konsiderojm se AK duhet te: përcaktojë përmbajtjen minimale të planit të menaxhimit të trafikut dhe planit dinamik (gantogramit), duke ofruar udhëzime të qarta mbi:
  - elementet përbërëse që duhet të përfshihen;
  - formatin e pranueshëm dhe metodat e vlerësimit.
- Në të kundërt, kërkesat e formuluara në këtë mënyrë duhet të eliminohen ose neutralizohen nga procesi i vlerësimit, për të mos u përdorur si bazë për përjashtim të ofertave.

Pika 5: Paqartësi në kriterin e vlerësimit për periudhën e garancisë – Shkelje e nenit 60 të LPP.
Në Aneksin 6 është përdorur gabimisht formula "100 x 10%" për një kriter që peshon realisht 30%. Kjo është paqartësi që bie ndesh me nenin 60 të LPP, i cili kërkon që kriteret dhe metodat e vlerësimit të jenë të qarta dhe transparente për të gjithë pjesëmarrësit.

Pika 6 dhe me rëndësishmja per nga shkelja e ligjit nga ana e AK

Gjatë rishikimit me te detajuar të dokumentacionit të tenderit kemi vërejtur se:

- Tek pika 2.2 është vendosur një formulë në kolonën D13 e cila gjatë plotësimit të paramanës, sapo te plotësohet kolona E30 automatikisht zvogëlohet sasia për aq sa është vendosur çmim në atë kolonë.

D13 =19500-E30

	A	B	C	D	E	F
10						
11	2	PUNËT NË SHTRESËN QARKULLUESE	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total (€)
12	2.1	Largimi dhe prerja e asfaltit egzistues dhe materialeve tjera te demtuara nen shtresen e asfaltit per riparimin e demtimeve te medha.	m^2	21,445.50		-
13	2.2	Furnizimi, bartja dhe shtrirja e gjeotekstilit 400gr/m2	m^2	19,470.00		

- Një formulë e ngjashme është vendosur edhe ne Kolonën D15 pika 2.4, e cila po ashtu zbret automatikisht vlerën e sasise se vendosur ne D15 sapo te plotësohet çmimi njësi ne kolonën E41 e vendosur nga ofertuesi.

D15 =4289.1-E41

	A	B	C	D	E	F
10						
11	2	PUNËT NË SHTRESËN QARKULLUESE	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total (€)
12	2.1	Largimi dhe prerja e asfaltit egzistues dhe materialeve tjera te demtuara nen shtresen e asfaltit per riparimin e demtimeve te medha.	m^2	21,445.50		-
13	2.2	Furnizimi, bartja dhe shtrirja e gjeotekstilit 400gr/m2	m^2	19,470.00		
14	2.3	Punimi i shtreses stabilizuese (60MN/m2) te trupit te rruges me gure nga gurethyesi me dimensioni 0-150 mm me ngjeshje ne shtresa çdo 30 cm.	m^3	6,433.65		-
15	2.4	Furnizimi, vendosja dhe ngjeshja me modul ngjeshmërie Mv=80 N/mm² i tamponit 0-61.5 mm, në trashësi t=20 cm.	m^3	4,239.10		-

Këto formula, të vendosura pa ndonjë arsyetim teknik apo sqarim shtesë, përbëjnë ndërhyrje të drejtpërdrejtë në procesin e ofertimit, duke kufizuar operatorët ekonomikë në ofertimin e lirë dhe të drejtë të çmimeve të tyre. Si rrjedhojë, kjo praktikë bie ndesh me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe përbën kriter të natyrës diskriminuese, që mund të ndikojë në transparencën dhe besueshmërinë e procesit të prokurimit.

Këto formula janë vendosur në mënyrë që të përjashtojnë potencialisht ofertues të tjerë që i plotësojnë kushtet teknike e profesionale, dhe nuk është hera e parë që jemi duke e hasur këtë gjë,
Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë se kjo praktikë e vendosjes së formulave automatike në paramasa nuk është rasti i parë që hasim në dokumentacionin e përgatitur nga Autoriteti Kontraktues.
Probleme të ngjashme kemi vërejtur edhe në projekte të tjera të publikuara më parë nga i njëjti AK, ku në mënyrë të përsëritur janë vendosur formula që ndikojnë në mënyrë jo transparente çmimet e ofertuesve. Ajo që bie në sy është fakti se në këto raste, fituesi i kontratave ka qenë vazhdimisht i njëjti operator ekonomik, gjë që ngrit dyshime të arsyeshme mbi barazinë e trajtimit të ofertave dhe mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit. Në këtë drejtim, kërkojmë me përgjegjësi

që kjo praktikë të rishqyrtohet me seriozitet dhe të sigurohet një procedurë përzgjedhjeje që është plotësisht në përputhje me parimet e konkurrencës së ndershme dhe transparencës.

Prandaj, kërkojmë nga OSHP që, duke u mbështetur në kompetencat ligjore të parapara me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), të ndërmarrë hapat e nevojshëm për trajtimin e kësaj çështjeje dhe, në të njëjtën kohë, të iniciojë menjëherë një hetim administrativ ndaj autoritetit kontraktues.

Po ashtu, kërkojmë që të shqyrtohet mundësia për ndërmarrjen e masave disiplinore që mund të çojnë deri te revokimi i licencës për menaxherin e prokurimit në këtë institucion, për shkak të shkeljeve të rënda dhe sistematike të procedurave të prokurimit.

Si operator ekonomik, theksojmë se nuk do të ndalemi së ndjekuri këtë çështje përmes të gjitha mjeteve juridike të parapara me legjislacionin në fuqi, deri në instancat më të larta ligjore.

Duke qenë të vetëdijshëm se autoriteti kontraktues mund të ndërmarrë ndryshime në dokumentin "paramasë" sapo të njoftohet për ankesën, të njëjtin dokument jua bashkëngjisim me këtë email. Rekomandojmë që "paramasa" të rishikohet nga ekspertët përkatës brenda OSHP-së, me qëllim të pamundësimit të ndërhyrjeve të mëvonshme apo manipulimeve eventuale nga ana e autoritetit kontraktues.

Si Përfundim

Kerkesat dhe kriteret e specifikuara në dosjen e tenderit janë të tepruara dhe kufizuese, duke krijuar pengesa të panevojshme për konkurencën dhe mundësitë e pjesëmarrësve të tjerë. Këto kërkesa diskriminojnë operatorët ekonomikë që mund të ofrojnë shërbime të cilësisë së kërkuar, por që nuk disponojnë pajisje specifike ose numrin e nevojshëm të makinave të kërkuara. Përshtatja e kushteve të tenderit në favor të disa operatorëve të caktuar i redukton mundësitë për konkurrencë të drejtë dhe transparente, duke shkelur parimet e barazisë dhe transparencës që garantohen nga ligji për prokurimin publik. Kërkohet rishikimi i këtyre kritereve për të mundësuar pjesëmarrjen e një game më të gjerë operatorësh dhe për të siguruar një proces të drejtë dhe të hapur tenderimi. Me theks te veqanet perms kesaj ankese kerkojm nga OSHP qe te:

Shfuqizojë vendimin e Komunës së Rahovecit të datës 12.05.2025 si të pabazuar dhe të padrejtë;

Urdhërojë ndryshimin e dokumentacionit të tenderit duke:

- Larguar ne tërësi nga dosja e tenderit dhe njoftimi per kontratë, kërkesën për dron, ose ndryshuar specifikat për të eliminuar diskriminimin;
- Larguar kërkesat për noterizim;
- Rishikuar specifikimet teknike kufizuese (grejderi);
- Qartësuar termat e pa matshëm ("sa më i detajuar");
- Saktësuar metodën e vlerësimit të ofertave.

Shtyjë afatin e dorëzimit të ofertave për të siguruar konkurrencë të drejtë dhe pjesëmarrje efektive.

Dispozitat e shkelura nga ana e autoritetit kontraktues

Neni 1 – Qëllimi

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm qe nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1,2,4 i cili thotë se:

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm qe nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1 i cili thotë se:

1.Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Neni 7 - *Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi*

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm qe nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1,2,4 i cili thotë se:

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2.Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

3.Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

6.Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm qe nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1,2, i cili thotë se:

Neni 28
Specifikimet teknike

1. *Autoriteti kontraktues do ti parashtrojë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues (i) do të parashtrojë specifikimet e tilla në njoftimin në fjalë, ose (ii) do të dërgojë një deklaratë të qartë që tregon se ku mund të merren specifikimet e tilla teknike. Kurdo që është e mundur këto specifikime teknike duhet të definohen në atë mënyre sa që të merren parasysh kriteret për mundësinë e qasjes së personave me aftësi të kufizuar apo dizajnimin për të gjithë shfrytëzuesit.*

2. *Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.*

Duke u bazuar në dëshmitë dhe sqarimet e ofruara më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e **OE:** *"JOOS&KRASNIQI-BAZË" SH.P.K*
ANULOHET njoftimi per kontratë dhe vendimi AK-së I dates 12.05.2025
DETYROHET autoriteti kontraktues që te rishikoj dosjen e tenderit dhe njoftimin per kontratë dhe te njejtat të bëhet në harmoni dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Përveç shkeljeve të konstatuara më parë, ne gjithashtu jemi të dëmtuar nga shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes se kërkesës për rishqyrtim, si dhe ankeses. Këto shpenzime përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- **Shpenzimet për përgatitjen e Kërkesës për Rishqyrtim dhe ankeses**: Këto përfshijnë kostot për hartimin e kërkesës, mbështetjen ligjore dhe administratën e nevojshme për paraqitjen e ankesës, si dhe përgatitjen e dokumentacionit dhe provave përkatëse.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË

NJOFTIM PËR KONTRATË

☒ ***PUNË*** ☐ ***FURNIZIM*** ☐ ***SHËRBIME***

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 28.04.2025

Nr i Prokurimit	**623-25-1580-5-1-1**
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☒

NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: **KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**		
Adresa Postare: **XHELAL HAJDA TONI**		
Qyteti: **RAHOVEC**	Kodi postar: **21000**	Vendi: **Kosovë**
Personi kontaktues: **Astrit Mullabazi**	Telefoni: **+38 20045316**	
Email: **prokurimi.rahovec@gmail.com** **prokurimi.rahovec@rks-gov.net**	Faksi:	
Adresa e Internetit (*nëse aplikohet)*: **https://kk.rks-gov.net/rahovec/**		

Po ☐ Jo ☒

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:
Asfaltimi i rrugës Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastasel – Polluzhë

II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit
(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

☒ **Punë**	☐ **Furnizime**	☐ **Shërbime**
☒ Ekzekutim ☐ Plani dhe ekzekutimi ☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	☐ Blerja ☐ Qira financiare (lizing) ☐ Qira ☐ Blerje me këste ☐ Një kombinim i këtyre	

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit
Në Komunën e Rahovecit

II.1.3) Njoftimi përfshinë

Krijimin e kontratës publike kornizë
☐

II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë *(nëse aplikohet):*

Kontrate publike kornizë me një operator
☐

Kontrate publike kornizë me disa operator
☐

Ekzekutimi i kontratës:

Thirrje/Porosi
☐

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë
☐

Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës
Asfaltimi i rrugës Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastasel – Polluzhë

II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):

45233222-1

II.1.7) Variantet pranohen

Po ☐ **Jo** ☒

II.1.8) Ndarja në Pjesë

Po ☐ **Jo** ☒

Nëse po, tenderët mund të dorëzohen për *(shënoni vetëm një kuti)*

☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët

II.1.9) Informacione lidhur me pjesët (*nëse aplikohen)*

Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër

Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:

II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 3,873,071.99

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm *(përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)*
Sipas Përshkrimit të Çmimeve

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj **24** apo ditë (nga dhënia e kontratës)
apo
Fillimi
Përfundimi

NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose **10 % e vlerës së kontratës** % e vlerës së kontratës

III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t`u jepet kontrata *(nëse aplikohet)*:
Në bazë të nenit 26.15, të ndryshim plotësimit të Rregullores Nr. 001 2022 për Prokurimin Publik, Operatorët Ekonomik që marrin pjesë si grup, së bashku me ofertën e tyre duhet të ofrojnë një Marrëveshje (deklaratën) për themelimin e grupit, në të cilën anëtarët e grupit do t'i përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë, si dhe të gjitha veprimet procedurale që duhet t'i kryej lideri i grupit në

emër të grupit. Plotësimi i Marrëveshjes (deklaratës) për themelimin e grupit, i vendosur në Aneksin 7 Deklarata per themelim te grupit, është obligative për Operatorët Ekonomik që marrin pjesë si grup.
III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës **Po** ☐ **Jo** ☒ ***Nëse po,*** përshkrimi i kushteve të veçanta

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: **Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http krpp.rks-gov.net**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1 Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042, Plotësimi I Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit** **Dëshmia 2 Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.** **Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.** **Dëshmia 3 Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore.** **Për piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik të propozuar për shpërblim me kontrate në sjelljen e dokumenteve te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën e tij ta refuzoj, te konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dyte.**
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

Kërkesa 1 Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin professional, komercial dhe ose regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit	**Dëshmia 1 Certifikatën e regjistrimit te Biznesit – se bashku me informatat për biznesin, te lëshuar nga Autoritetet e Regjistrimit te Biznesit – Kopje**
Kërkesa 2 Regjistrimi i TVSH – së	**Dëshmia 2 Certifikatën e TVSH – Kopje**
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve te fundit, në vlerë jo më pak se 7,740,000.00 €uro, Ne rast koncersiumi lideri duhet te ketë te paktën 60 % te vlerës se qarkullimit;	**Dëshmia 1 Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK ose Raport nga Banka e vulosur dhe e nënshkruar origjinale nga ndonjë banke e licencuar ne Kosovë**
Kërkesa 2 Operatori Ekonomik duhet të ketë Kapital te mjaftueshëm për realizimin e kontratës, në vlerë prej 1,161,000.00 €, mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania, duke specifikuar titullin e projektit dhe nr. e prokurimit për aktivitetin ne fjale, ose mbështetje të pakushtëzuar nga Institucioni Bankar, duke emërtuar projektin per te cilin lejohet kredia, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% të mbështetjes bankare;	**Dëshmia 2 Deklaratë nga banka që dëshmon se Operatori Ekonomik, ka mjete të gatshme në xhirollogari ose mbështetje të pakushtëzuar nga Institucioni Bankar për ketë projekt, Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar lidhur me këtë projekt;**
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1 Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, min. 50 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperienca (vite) dhe pozicioni në kompani;	**Dëshmia 1 Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve, min. 50 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperienca (vite), pozicioni në kompani – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, per secilin punëtor te prezantuar ne liste duhet te dëshmohet përmes listës së ATK-së si dhe dëshmi nga Banka (Lista e pagave) të Operatorit ekonomik që dëshmon se ka kryer obligimet ndaj punëtorëve për gjashtë (6) muajt e fundit duke bashkangjitur dëshminë (konfirmimin) bankar;**
Kërkesa 2 Operatori Ekonomik duhet te ketë ne listën te paktën këtë staf professional 2.1. Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, Të ketë dëshmi se ka menaxhuar projekte të realizuara në lëmine e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve, si dhe se paku dy (2) projekte te menaxhuara ne zgjerim te rrugëve; 2.2. Udhëheqësi i Punishtes – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, Të ketë dëshmi se ka udhëhequr projekte të realizuara në lëmine e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve, si dhe se paku dy (2) projekte te udhëhequr ne	**Dëshmia 2 • Diplomat përkatëse – Kopje; • CV-ja (e nënshkruar nga vete inxhinieri); • Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt, (Nëse prezantoni kontrata te rregullt te dëshmohet me liste te ATK ne tre (3) muajt e fundit, nëse prezantoni marrëveshje per projekt, marrëveshja duhet te jete e përpiluar në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03 L-212; • Një deklarate me shkrim nga Inxhinerët e Stafit Profesionale, ku deklarojnë se do të jenë të angazhuar për këtë projekt, duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar nga vetë inxhinieri; • Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e**

zgjerim te rrugëve; 2.3. Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit, ose Bachelor i Ndërtimtarisë – Drejtimi Konstruktiv, me 5 vite përvojë pune pas diplomimit, Të ketë dëshmi se ka realizuara projekte në lëmine e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve; 2.4. Inxhinier i Diplomuar ose Master i Gjeodezisë me (3) tri vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka realizuar projekte në lëminë e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve, si dhe se paku 2 projekte ne zgjerim te rrugëve; 2.5. Inxhinier i Diplomuar i Komunikacionit me (3) tri vite përvojë pune pas diplomimit ose Bachelor i Komunikacionit me (5) pesë vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka realizuar projekte në lëminë e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit te rrugëve, si dhe se paku 2 projekte ne zgjerim te rrugëve; 2.6. Inxhinier i Diplomuar i Hidroteknikës ose Master diplome, me (3) tri vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka realizuar projekte në lëminë e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve, si dhe se paku 2 projekte ne zgjerim te rrugëve;	**kërkuar e lëshuar nga punëdhënësi;** **• Një deklarate me shkrim për caktimin e Menaxherit te Projektit dhe Udhëheqësit të Punishtes, duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për pikën 2.1 & 2.2;** **• Licenca e Kopje e Gjeodetit, për pikën 2.4;**
Kërkesa 3 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka realizuara me sukses kontrata të natyrës në lëmin e ndërtimit, rikonstruktimin dhe zgjerimit të rrugëve, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 5,809,000.00 €uro;	**Dëshmia 3 Lista e punëve te realizuara, duke plotësuar ANEKSIN 8 të Dosjes se Tenderit, në lëmin e ndërtimit, rikonstruktimin dhe zgjerimit të rrugëve, të realizuar në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, DHE kësaj liste duhet ti bashkëngjiten si dëshmi (i) kur punët janë bërë për një Autoritet Publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikata raporti i përkohshëm i pranimit) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë, të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar,** **(ii) kur punët janë bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë me dëshmi të pagesës nga banka;**
Kërkesa 4 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me këto Certifikata ISO **- ISO 9001-2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë) - ISO 39001-2012 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugore) - BS PASS 99-2012 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Integruar) - ISO 14001-2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit) - ISO 28001-2007 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë për Zingjirin e**	**Dëshmia 4 Certifikatat Kopje dhe Valide;**

Furnizimit)	
Kërkesa 5 Raporti i vlerësimit të riskut në vendet e punës, nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për Siguri dhe shëndet në punë, se ka kryer vlerësimin e riskut konform ligjit 04 L-161 dhe së paku Njëzetepesë (25) punëtor të jenë të trajnuar certifikuar për siguri dhe shëndete në punë, (punëtor në kuadër të Kërkesë Nr. 1 min. 50 punëtor);	**Dëshmia 5 Kopje e raportit të vlerësimit të riskut në vendet e punës, kopje e Licencës së kompanisë së licencuar për ushtrimin e punëve nga siguria dhe shëndeti në punë, po ashtu Certifikata për punëtor të trajnuar certifikuar për siguri dhe shëndetë në punë;**
Kërkesa 6 Operatori Ekonomik duhet te ketë Bazë për prodhimin e Asfaltit me kapacitet min. 240 t h, te licencuar ne Pronësi ose marrëveshje për furnizim, Bazë për prodhimin e Betonit te licencuar ne Pronësi ose marrëveshje për furnizim, Gurthyes të licencuar ne Pronësi ose marrëveshje për furnizim;	**Dëshmia 6 Kopje e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjencioni per Miniera dhe Minerale në pronësi. Ne rastet kur Operatori Ekonomik ka marrëveshje per furnizim, duhet specifikuar projektin dhe kohëzgjatjen e tij. Marrëveshja duhet te jetë origjinale mes qiradhënësit dhe qiramarrësit;**
Kërkesa 7 Operatori Ekonomik duhet te ofroj se bashku me oferte planin për menaxhimin e trafikut sa më të detajuar duke përfshira përshkrimin dhe skicat e rrugës e cila do te realizohet;	**Dëshmia 7 Origjinali i planit të menaxhimit të trafikut i nënshkruar nga Inxhinieri ose Bachelor i Komunikacionit dhe plani i menaxhimit duhet te jetë i vulosur nga kompania;**
Kërkesa 8 Operatori Ekonomik duhet te ofroj se bashku me oferte Plani Dinamik per realizimin e projektit;	**Dëshmia 8 Plani dinamik sa me i detajuar – Gantogrami, i punuar Menaxheri i Projektit dhe Udhëheqësi i Punishtes, dhe duhet te jetë i nënshkruar dhe vulosur nga kompania;**
Kërkesa 9 Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 9 te Dosjes se Tenderit;	**Dëshmia 9 Operatori ekonomik duhet të plotësojë listën e pajisjeve sipas kërkesës ne Aneksin 9 te Dosjes se Tenderit, Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik, ku listës së pajisjeve duhet ti bashkëngjiten edhe dëshmitë mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas listës se ne Aneksin 9 te Dosjes se Tenderit), Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera Operatori Ekonomik duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (Faturë, DUD ose kontratat e shitblerjes. etj.)** **Vëmendje!** **Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët në prezencë të noterit; Dëshmitë per pajisjet duhet te ofrohen te renditura sipas listës se bashkangjitur ne Aneksin 9 te Dosjes se Tenderit, Gjithashtu të epen karakteristikat gjegjësisht specifikat teknike të veçanta per secilën nga pajiset, Dëshmitë duhet te jene te**

	dukshme;

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

Po ☐ **Jo** ☐

III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar

Nëse po, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse

III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve

Po ☐ **Jo** ☐

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

IV.1.1) Lloji i procedurës

☒ **E hapur**

☐ **E kufizuar**

☐ **Konkurruese me negociata**

☐ **Kuotim i Çmimit**

IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim *(procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)*

Në bazë të aplikacioneve të pranuara, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për proceduren e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave *(procedurë konkurruese me negociata)*

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme

Po ☐ **Jo** ☐

në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar

Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë
kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata

Po ☐ **Jo** ☐

IV.1.4 Numri minimal i kandidateve te cilët do te ftohen qe te dorëzojnë
Tenderët fillestar është:

IV.1.5. Informata ne lidhje me ankandin elektronik

Do te përdoret ankandi elektronik: Po ☐ Jo ☒

Informata shtese ne lidhje me ankandin elektronik:

IV.2) KRITERET E DHËNIES

☐ **Çmimi më i ulët**

ose

☒ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të**

	Nënkriteret	Koeficient
1	Çmimi	0.70
2	Afati me i gjate i Periudhës Garantuese deri ne max. 36 Muaj	0.30

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po,

Njoftim paraprak: **2025/623-25-1580-5-1-1/001-0004601 11.03.2025** i

Publikime tjera (*nëse aplikohen):*

i

i

Po ☐ **Jo** ☒

Dokumentet me pages

Nëse po, çmimi EUR

Kushtet dhe metoda e pagesës:

IV.3.2) Afati i fundit për pranim të *tenderëve / aplikacioneve:*

data **23.05.2025** ***koha*** **14:00:00** ***vendi*** **https e-prokurimi.rks-gov.net**

IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e *tenderëve / aplikacioneve* është shkurtuar:

☒ **Po** ☐ **Jo**

Nëse po, jep arsyetim **Me Urdhëresë nga Kryetari i Komunës me Nr. 5572, Nr. i faq. 60, datë 08.04.2025, për përdorimin e afateve të përshpejtuara kohore gjatë aktiviteti të prokurimit, e cila Urdhëresa arsyetohet, duke cekur Arsyetim Pas deformimeve dhe qarjeve të shumta në këtë segment rrugor dhe duke e ditur rrezikun permanent për sigurinë në trafik që mund të shkaktohet, është e domosdoshme që të zhvillohet procedura e tenderimit dhe të ketë afate të përshpejtuara. Ne kuadër të këtij projekti janë përfshirë nevoja për trajtim të ujërave atmosferike, mureve mbrojtëse, pahive mbrojtëse (pjesët metalike të anësoreve që krijojnë siguri gjatë lëvizjes së makinave). Në shumicën e këtij segmenti rrugor kemi deformime dhe plasaritje në rrugë për shkak të prishjes dhe gropave që janë krijuar. Përveç kësaj, kjo rrugë ka nevojë urgjente largimin e shtyllave elektrike që janë përgjatë brezit rrugor (ky projekt ka paraparë edhe bashkëpunimin me ndërmarrjet publike, si K.R.U. "Gjakova", KEDS-i, kompani kabllore), që janë si pasojë e projekteve të vjetruara elektrike e kabllore e që duhen trajtuar sepse gjendja aktuale e këtyre shtyllave, sidomos të atyre të drurit, shkaktojnë rrezik permanent për pjesëmarrësit në trafik dhe për qytetarët. Ky projekt e ndihmon dhe i jep impakt të ri trajtimit të rrugëve që lidhin disa fshatra me zonën urbane të qytetit të Rahovecit. Për të kompletuar në tërësi këtë projekt, është më se e nevojshme që të zhvillohet procedura e afateve të përshpejtuara kohore, duke u bazuar gjithherë në Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës. Shkurtimi behet sipas Nenit 6.5, pika b, të RrUOPP–së, pasi qe është respektuar afati per Njoftim paraprak per ketë procedure te prokurimit.**

IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit:

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, vlera e sigurisë së tenderit **77,000.00 €uro**
Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë **120** *apo* muaj

IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:
Deri më: data: ditët **90** apo muajt

IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:

data 23.05.2025 koha 14:00:00 vendi https e-prokurimi.rks-gov.net

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.

V.2) INFORMACIONET SHTESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.

Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita ne punishte etj)

• Autoriteti Kontraktues Komune Rahovecit ju informon se sipas vendimit te KRPP – se Nr. 91 2018 dhe RRUOP, që tenderi duhet të dorëzohet vetëm në mënyrë elektronike (ne asnjë mënyrë ne versionin tjetër). Ky është kusht i tenderit i cili duhet respektuar për te mundësuar pranimin e ofertës si te "përgjegjshme" administrativisht. • Në pamundësi teknik për të ngarkuar në sistem e prokurimit projektin detal, ju informojmë se komplet projektin mund te merrni ne Zyrën e Prokurimit – Komuna e Rahovecit, ne forme fizike

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA E RAHOVECIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **Asfaltimi i rrugës Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastasel – Polluzhë**

Nr i Prokurimit	**623-25-1580-5-1-1**
Nr i brendshëm	**623-25-026-5-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Asfaltimi i rrugës Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastasel – Polluzhë**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"Joos&Krasniqi-Bazë" SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Junik
(Adresa)

Komuna e Junik — *51050*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

+383 49 766 804 — _____
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Agron Krasniqi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@jooskrasniqi.com
(Adresa elektronike)

08.05.2025 — _____
(Data e parashtrimit të kërkesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

SH.P.K JOOS KRASNIQI-BAZE 810962309 JUNIK

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1. Data e njoftimit për kontratë - 28.04.2025
2. Data e planifikimit te hapjes se ofertave - 23.05.2025
3. Kërkesa për Rishqyrtim – 08.05.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☑

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☑

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- **Neni 1 - LPP – Qëllimi**
- **Neni 6 - Ekonimiciteti dhe efikasiteti**
- **Neni 7 - LPP - Barazia ne Trajtim/ Jo- Diskriminimi.**
- **Neni 28 - LPP - Specifikimet teknike**
- **Neni 69 - LPP - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale**
- **Neni 71 – LPP- Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik**

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Kronologjia e fakteve dhe Analiza e Kërkesës për Rishqyrtim

Kërkesë për Rishqyrtim të Vendimit të Autoritetit Kontraktues

Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), konkretisht neni 108A, parashtrojmë kërkesën për rishqyrtim ndaj njoftimit për kontratë të autoritetit kontraktues, Komuna e Rahovecit të datës 28.04.2025, konkretisht ndaj kërkesave dhe specifikave te tenderit dhe kritereve te vlerësimit ne tenderin e shpallur me emër: **Asfaltimi i rrugës Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastasel – Polluzhë**

Kërkesa për rishqyrtim do te fokusohet ne kriteret e atakuara nga ana e jonë si me poshtë:

(Pika 1)

Kriteri qe konsiderojmë si diskriminues është:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Kërkesa Numër 9, Ku është cituar "***Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët në***

prezencë të noterit", ky është kriter diskriminues andaj duhet të largohen të gjitha noterizimet sepse sipas **RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK Të hyrë në fuqi me 11.11.2024, Neni 26.16** ku citohet "***26.16 Autoriteti Kontraktues në rast të dyshimit të cilitdo informacion të dorëzuar nga Operatori Ekonomik, do të kryej një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit tek autoriteti / personi fizik përkatës dhe rrjedhimisht kërkesa e Autoritetit Kontraktues për noterizim të dokumenteve konsiderohet e panevojshme***", andaj kërkojmë nga ju si AK të rrespektoni **RREGULLOREN PËR PROKURIMIN PUBLIK,** dhe ta ndryshoni këtë kërkese në lidhje me **NOTERIZIMET** dhe ta largoni si kërkesë nga FDT.

Po ashtu pasi që jemi te kjo pikë kiter diskriminues janë edhe makineritë të cilat kanë pesha dhe emertime specifike andaj kërkojmë që të ndryshohen si p.sh.

- **Grejder me repera dhe llaser digjital për nivelizimin e rrugëve pesha min. 19 – 20 ton**
  - Makinë me peshe specifike prej 1 ton diferenca, andaj kerkojme te caktohet nje minimum e jo te kufizohet p.sh max 20 ton.
- **Dron profesional i dedikuar për inspektim, monitorim apo rilevim gjeodezik, i pajisur me kamerë digjitale me rezolucion jo me pak se 60 megapixel. Droni duhet te ketë mundësinë matjes me PPK (Post processing konematic) dhe softuerin e procesimit PPK. Duhet te prezantohet aprovimi valid nga AAC (Autoriteti i Aviacionit Civil) për dronin e prezantuar i cila duhet të jetë në emër të Inxhinierit për operimin si dhe të prezantohet certifikata (Kopje e noterizuar nga Inxhinieri). Inxhinieri duhet te jete i trajnuar/certifikuar per përdorim te dronit profesional nga një person i certifikuar nga prodhuesi.Te prezantohet specifikacioni nga prodhuesi i dronit per dronin dhe kamere.**
- Droni me kamere digjitale me rezulucion jo me pak se 60 megapixel është kriter diskriminues sepse edhe nje dron me kamere jo me pak se 30 ose 40 megapixel e kryen punen e njejte dhe eshte i mjaftueshem ashtu siq edhe dosjet e kaluar ju ka kryes pune andaj kjo prej 60 megapixel eshte e pa nevojshme.

Kriteret e kërkuara si me lartë, si kufizimi i peshave të pajisjeve, specifikimi i modeleve të veçanta të pajisjeve si dhe kërkesa për një numër të caktuar kamionësh dhe eskavatorësh, pa lënë mundësi për alternativa, pa dyshim paraqesin kufizime të padrejta për konkurrencën dhe janë në kundërshtim me parimet e ligjit të prokurimit publik. Këto lloj kriteresh mund të favorizojnë disa operatorë ekonomikë, duke krijuar një barrierë të padrejtë për ata që nuk kanë në dispozicion pajisjet e kërkuara ose nuk mund të përmbushin kërkesat e tepruara të numrit dhe specifikimeve.

Dispozitat e shkelura nga ana e autoritetit kontraktues

Neni 1 – Qëllimi

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm qe nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1,2,4 i cili thotë se:

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do

të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm qe nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1 i cili thotë se:

1.Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Neni 7 - *Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi*

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm qe nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1,2,4 i cili thotë se:

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2.Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

3.Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose

diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

6.Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm qe nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1,2, i cili thotë se:

Neni 28
Specifikimet teknike

1. *Autoriteti kontraktues do ti parashtrojë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues (i) do të parashtrojë specifikimet e tilla në njoftimin në fjalë, ose (ii) do të dërgojë një deklaratë të qartë që tregon se ku mund të merren specifikimet e tilla teknike. Kurdo që është e mundur këto specifikime teknike duhet të definohen në atë mënyre sa që të merren parasysh kriteret për mundësinë e qasjes së personave me aftësi të kufizuar apo dizajnimin për të gjithë shfrytëzuesit.*

2. *Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.*

Bazuar ne përshkrimin e mësipërm kërkojmë nga Autoriteti kontraktues respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit qe te nxjerr ketë:

VENDIM
APROVOHET, si e bazuar Kërkesa **"Joos&Krasniqi-Bazë" SH.P.K** për Rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Asfaltimi i rrugës Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastasel – Polluzhë,** të plotësoni dhe rregulloni dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë me vërejtjet tona si në Kërkesë për Rishqyrtim.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

1. Përgatitja e ofertës së bashku me shpenzime përcjellëse 2. Shpenzimet e përfaqësimit dhe avokatit për përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim dhe në rast refuzimi paraqitja dhe përfaqësimi i ankesës në OSHP, 3. Kompensimin e dëmit në rast të mohimit/refuzimit të kërkesës, duke pretenduar që kemi plotësuar te gjitha kushtët/kriteret.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA **KOMUNA E RAHOVECIT** OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	

Për:	**Operatorë Ekonomik: "JOOS&KRASNIQI-BAZË" SH.P.K** me adresë në **JUNIK** **Operatorëve Ekonomik** **Të gjitha palëve të interesuar**
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	**VENDIM** për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	**12.05.2025**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1.1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **08.05.2025**, në Ora: **16:44 h**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **"JOOS&KRASNIQI-BAZË" SH.P.K.** me adresë në **JUNIK**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Asfaltimi i rrugës Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastasel – Polluzhë**, me Numër të prokurimit: **623-25-1580-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-026-5-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **"JOOS&KRASNIQI-BAZË" SH.P.K.** me adresë në **JUNIK**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Asfaltimi i rrugës Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastasel – Polluzhë**, me Numër të prokurimit: **623-25-1580-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-026-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **28.04.2025**, të publikuar në ueb–faqe: https://e-prokurimi.rks-gov.net

II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **Asfaltimi i rrugës Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastasel – Polluzhë**, me Numër të prokurimit: **623-25-1580-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-026-5-1-1**

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: https://e-prokurimi.rks-gov.net

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik: **"JOOS&KRASNIQI-BAZË" SH.P.K.** me adresë në **JUNIK**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Asfaltimi i rrugës Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastasel – Polluzhë**, me Numër të prokurimit: **623-25-1580-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-25-026-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **28.04.2025**, të publikuar në ueb–faqe: https://e-prokurimi.rks-gov.net, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **08.05.2025**, në Ora: **16:44 h**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza ligjore e kërkesës

- Në lidhje me pretendimin ankimor se kërkesa që "**Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët në prezencë të noterit është kërkesë diskriminuese**", sqarojmë se kjo kërkesë krijon siguri të marrëveshjeve për makineritë dhe vlen për të gjithë kompanitë prandaj nuk mund të quhet diskriminuese për ndonjë kompani e favorizuese për ndonjë tjetër.

  Rregullore Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nuk shkruan askund që është obligative të largohen noterizimet, ndërsa fjala e panevojshme nuk është obligative, kurse ne për të shmangur mundësinë e verifikimeve të shumta të dokumenteve kemi menduar që disa dëshmi të janë të noterizuara dhe mendojmë se kjo kërkesë nuk paraqet ndonjë problem për kompanitë dhe nuk paraqet shpenzime të mëdha, prandaj konsiderojmë se kjo kërkesë më shumë ka të bëjë me efikasitetin e procedurës së prokurimit, që të mos ketë vonesa në verifikime të ndryshme të dokumenteve, prandaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

- Në lidhje me pretendimin e Operatori Ekonomik ankues se Grejderin me repera dhe llaser digjital për nivelizimin e rrugëve pesha min. 19-20 ton, është kërkesë e panevojshme dhe kufizuese, sqarojmë se edhe ky pretendim nuk është argumentuar në asnjë mënyrë përse është kufizues kjo kërkesë. Tonazha e kërkuar përkon me natyrën dhe qëllimin e këtij tenderi dhe është përcaktuar hapësirë e mjaftueshme e tonazhës ndërmjet minimumit dhe maksimumit.

Duke pasur parasysh të gjitha pozicionet e përcaktuara në paramasë janë kërkuar edhe makineritë dhe specifikimet e tyre, prandaj në këto raste lejohet të shfrytëzohen edhe kapacitetet e kompanive të tjera me marrëveshje ashtu siç e përcakton edhe Neni 69 paragrafi 8 ku ceket decidivisht që "**Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta"**. Nga ky nen kuptojmë që operatorët ekonomik mund të bashkëpunojë me operatorë të tjerë gjegjësisht të merr pajisje me qira për të plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit.

Po ashtu mund të ofertohet edhe në grup pasi që neni 71 i LPP e përcakton dhe lejon një gjë të tillë, kështu që operatorët ekonomik mund të bëjnë zgjidhje në kuadër të dispozitave të LPP për të plotësuar njëri tjetrin dhe për të ofertuar bashkërisht me kapacitete që i kanë secila kompani.

- Në lidhje me dronin e kërkuar dhe kontestimit nga ana e OE ankues, sqarojmë se droni është kërkuar sepse nevojiten matje dhe hartografi me saktësi më të lartë dhe mund të operojnë në kushte të ndryshme mjedisore. Realisht vetëm është përshkruar kërkesa për dron dhe vetëm është kërkuar që të ndryshohet kjo kërkesë pa dhënë ndonjë argument apo arsyetim konkret se përse duhet të ndryshohet kjo kërkesë dhe se çfarë pajisje mund të vendoset në vend të dronit, prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar. Është kontestuar rezolucioni jo më pak se 60 megapiksel duke tentuar ta shfaqin si specifikim diskriminues veçanërisht për ata që nuk kanë në dispozicion pajisje të tilla, mirëpo ne sqarojmë se rezolucioni jo më pak se 60 megapiksel është specifikim që përcakton minimumin e specifikës dhe në treg ka dronë të ndryshëm me 60 megapiksel, andaj nuk mund të quhet diskriminues. Sa i përket përcaktimit të mundësisë për matje me PPK (Post Processing Kinetamik), sqarojmë se kjo metodë është më e sofistikuar për përmirësim të saktësisë së të dhënave dhe kjo matje është shumë më e saktë se sa GPS standard, e cila ka disa përparësi të ndjeshme siç është eliminimi i devijimeve të cilat mund të shkaktohen nga atmosfera, nuk ka nevojë për lidhje me bazën dhe se funksionon shumë mirë në zona të izoluara duke qenë i përshtatshëm për terren ku sinjali i rrjetit nuk funksionon mirë.

  Dosja e hartuar në këtë mënyrë nuk bie në kundërshtim me ndonjë dispozitë të LPP e po ashtu OE ankues nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se dosja bie në kundërshtim me ndonjë dispozitë të LPP, prandaj pretendimi ankimor është i pa bazuar dhe i pa argumentuar.
- Në lidhje me pretendimin se kemi të bëjmë me shkelje të nenit 7 të LPP për favorizim të kompanive të caktuara, sqarojmë se kur kem parasysh paramasën dhe natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit si dhe kur kem parasysh faktin se ky tender është ndërkombëtar e ku mund të ofertojnë edhe kompani ndërkombëtare, përveç atyre vendore atëherë mundësia është e hapur për formim të grupeve të operatorëve ekonomik si vendor ashtu edhe ndërkombëtar, prandaj nuk ekziston asnjë favorizim për ndonjë kompani të caktuar.
- Edhe sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 28 të LPP-së, sqarojmë se edhe ky pretendim nuk ka mundur të arsyetohet në asnjë mënyrë dhe me fakte se përse ka shkelje të kësaj dispozite sepse specifikimet teknike të vendosura për pajisje nëse nuk mund të plotësohen vetë nga një OE atëherë është mundësia e ofertimit në grup me qëllim të plotësimit të kërkesave dhe specifikave teknike. Ashtu siç u cek më lartë edhe neni 69 është respektuar e ku OE mund të mbështeten tek kapacitetet e OE tjerë për të plotësuar kërkesat dhe dëshmitë në lidhje me tenderin përkatës.
- Pretendimi i OE ankues për shkelje të nenit 6 të LPP është pretendim i pa bazuar pasi që ekonomiciteti nuk mund të vie në shprehje kur kemi të bëjmë me kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë prandaj edhe ky pretendim është i pa bazuar.

Duke patur parasysh sqarimet dhe përgjigjet në lidhje me pretendimet ankimore kërkesa për rishqyrtim refuzohet si e pabazuar.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij **vendimi të AK–së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP–së në pajtim me nenin 109 të LPP–së. Ankesa pranë OSHP–së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:
Në platformën elektronike në adresën: https://e-prokurimi.rks-gov.net